

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7912  
E mërkurë, 23 tetor 2024  
Çmimi 0.50

## Riho Terras nga Estonia pritet të jetë raportues për Kosovën në PE



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# O'BRIEN: ASOCIACIONI NUK KRIJON NJË SHITRESË TJETËR TË PUSHTETIT NË KOSOVË

FAQE 5



Ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, gjatë vizitës së tij në Prishtinë, ka thënë

se pret nga Kosova ta dërgojë projekt-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për shqyrtim në Gjykatën

Kushtetuese, ndërsa theksoi se ky mekanizëm nuk krijon një qeverisje apo një shtresë tjetër të pushtetit

**VETËM 39 % E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT JANË ZBATUAR NGA KOMUNAT E KOSOVËS NË VITIN 2023**

F. 3



**PËR GJASHTË MUAJ MBI 60 MJEKË E LËSHUAN KOSOVËN**

F. 7



**ARKEP AUTORIZON STARLINKUN PËR TË OFRUAR SHËRBIME NË KOSOVË**

F. 8

## SPORT



**SONTE SUPERNDESHJA BARCELONË - BAYERN**

F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Kriza në Lindje të Mesme po përshkallëzohet, zgjidhjet diplomatike po zbehen

BEJRUT, 22 TETOR - Lufta e Izraelit në dy fronte, në Rripin e Gazës dhe Liban, si dhe kërcënimi për përshkallëzim me Iranin, i kanë vënë zjarrin krizës në Lindje të Mesme. Mirëpo, pavarësisht prej rrezikut për një luftë të madhe mes fuqive rajonale, Izraelit dhe Iranit, ekspertët vlerësojnë se nuk ka shumë apetit për zgjidhje diplomatike.

Ekspertët besojnë se situata është kështu pasi nuk ekziston një shtysë e madhe për paqe, dhe që aktorët e vetëm që mund ta ndryshojnë situatën, ose janë duke hezituar, ose janë në pozitë që mund të përfitojnë nga përshkallëzimi.

“Ekzistojnë zgjidhje diplomatike për krizën, mirëpo ato duhet të kenë në qendër çlirimin e Palestinës, sepse këtu është rrënja e konfliktit”, ka thënë Trita Parsi, bashkëthemelues i Institutit Quincy, me bazë në Uashington. Sipas tij, pengesa kryesore për të pasur një rezultat konkret qëndron te “refuzimi i Uashingtonit për ta shtyrë Izraelin që t’i japë fund pushtimit”.

Mirëpo, nëse Shtetet e Bashkuara “ndryshojnë rrënjësisht qasjen, këto zgjidhje diplomatike do të bëhen mjete politike”.

Shtetet e Bashkuara janë aleatet kryesore të Izraelit, të cilat e furnizojnë me armë dhe ndihmë tjetër këtë shtet. Pavarësisht prej kësaj, Izraeli e ka çuar përpara planin e vet, duke i rezistuar edhe presionit amerikan, andaj është e paqartë nëse edhe lojtarët e tjerë në luftë do t’i zvogëlonin aktivitetet ushtarake si përgjigje ndaj shtensionimit izraelit.

Izraeli është aktualisht i përfshirë në dy fronte të luftës kundër grupeve të përkrahura nga Irani dhe të shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara.

Bëhet fjalë për Hamasin në Rripin

e Gazës dhe Hezbollahun në Liban.

Izraeli e ka nisur luftën në Gazë një vit më vonë në shenjë hakmarrjeje për sulmet vdekjeprurëse të Hamasit në territorin e tij.

Së fundmi, lufta është zgjeruar edhe në Liban, pasi Izraeli, përmes bombardimeve ajrore dhe inovacionit tokësor, po synon ta shkatërrojë infrastrukturën e Hezbollahut dhe t’ia pamundësojë sulmet me raketa.

Hezbollahu është grup i armatosur dhe parti politike që kontrollon pjesën më të madhe në jug të Izraelit.

Bashkimi Evropian nuk e ka vënë në listë të zezë krahun politik të grupit i cili ka ulëse në Parlamentin e Libanit. Irani, i cili i ka ndihmuar Hezbollahun për katër dekada që t’i forcojë kapacitetet luftarake në luftën kundër armikut të përbetuar, Izraelit, është përfshirë edhe vetë në sulme direkte kundër Izraelit, në muajt e fundit, duke i rritur shqetësimet për një luftë të madhe mes dy shteteve me ndikim të madh në rajon.

Ekspertët i kanë thënë Radios Evropa e Lirë se ndonëse Izraeli po lufton në dy fronte, ai është më i interesuar që të angazhohet në përpjekjet diplomatike me Hamasin, me qëllim të lirimimit të pengjeve izraelite që mban Hamasin që një vit.

Sondazhet e fundit kanë treguar se opinionin publik izraelit e konsideron lirimimin e pengjeve si objektivin kryesor të luftës në Gazë.

Vrasja e liderit të Hamasit, Yahya Sinwar, organizatorit të dyshuar të sulmeve të 7 tetorit, dhe i konsideruar nga Uashingtoni si “pengesë e madhe për paqe”, shihet, gjithashtu, si një mundësi për ta ndryshuar kahen e situatës. Departamenti Amerikan i Shtetit



e ka karakterizuar vdekjen e Sinwarit - të vranë nga autoritetet izraelite më 17 tetor - si një mundësi për t’i dhënë fund konfliktit në Gazë dhe për ta garantuar lirimimin e pengjeve.

Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se tani është koha për të ecur përpara dhe për të arritur një armëpushim.

Në Liban vetëm Hezbollahu dhe aleati i tij i ngushtë Irani duan armëpushim, sepse grupi militant është përballur me “goditje të fuqishme”, sipas ekspertit për Lindje të Mesme, Kenneth Katzman, këshilltar i lartë në qendrën për konsulencë Soufan Group, me bazë në Nju-Jork. “Nuk mendoj që Izraeli dëshiron me doemos shumë diplomaci”, ka thënë ai.

Zyrtarët iranianë, në anën tjetër, kanë kryer një mori vizitash në shtetet e Gjirit Arab, në përpjekje e sipër për t’i bindur që ta parandalojnë Izraelin nga goditjet

në pika kyçe në Iran.

Shqetësimet për sulme izraelite kundër qendrave të naftës dhe atyre bërthamore janë rritur edhe më shumë prej kur Irani ka nisur rreth 180 raketa balistike ndaj Izraelit më 1 tetor.

Ndonëse disa shtete të Gjirit Arab i kanë normalizuar marrëdhëniet me Iranin dhe Izraelin, ekspertët janë skeptikë nëse ata kanë ndikim në arenën diplomatike. “Shtetet arabe kanë pak ndikim tek Izraeli, por kanë ndikim tek Uashingtoni”, ka thënë Parsi në disa komente me shkrim.

Ekspertët besojnë se shtetet e Gjirit Arab, por edhe Uashingtoni, përfitojnë nëse qëndrojnë larg, sepse duan ta shohin Hezbollahun duke u dobësuar sa më shumë që është e mundshme. Thanassis Cambanis, drejtor në Institutin Century Foundation, me bazë në Shtetet e Bashkuara, ka thënë se Arabia Saudite dhe shumica e vendeve të Gjirit Arab

“kanë gatishmëri të tolerojnë, ose edhe mbështesin” luftën kundër Hezbollahut, sepse u mundëson atyre ta rrisin konkurrencën ndaj Iranit në rajon.

Cambanis ka thënë se në Gazë “nuk ekziston shtytje” që Hamas dhe qeveria izraelite të punojnë drejt një armëpushimi, sepse zgjatja e konfliktit i ndihmon secilës palë të qëndrojë në pushtet. Sipas tij, një proces diplomatik që përfshin përfitime nga ana e Shteteve të Bashkuara “mund t’i japë lehtësisht fund konfliktit”. Megjithatë, ai ka thënë diplomacia nuk mund t’i zgjidhë problemet e tjera që ndërliqhen me luftën. “Nuk mendoj që është reale të presim që diplomacia të prezantojë një zgjidhje afatgjatë për konfliktin izraelito-palestinez. As nuk pres që diplomacia të gjejë urgjent një zgjidhje afatgjatë për mosmarrëveshjet në mes të Libanit dhe Izraelit”, ka thënë Cambanis.

## Britania do t’i japë Ukrainës 2.4 miliardë dollarë hua për blerje të armëve



LONDËR, 22 TETOR - Britania do t’i japë Ukrainës 2.4 miliardë dollarë hua për blerjen e më shumë sistemeve të armëve, njoftoi sekretari i Mbrojtjes, John Healey, më 22 tetor. Njoftimi vjen në kohën kur forcat e Kievit po përballen me luftime të ashpra me forcat ruse në lindje, ndërkaq përditë qytetet dhe infrastruktura ukrainase është cak i sulmeve ajrore.

Shuma e huas që Healey përmendi është pjesë e një huaje më të madhe në vlerë prej 50 miliardë dollarësh për Ukrainën që u bë publike në qershor nga Grupi i Shtatë

shteteve më të industrializuara (G7).

Paratë e kësaj huaje do të merren nga paratë e gjeneruara nga asetet e ngrira sovraane ruse në Perëndim, pasi Moskë nisi pushtimin e Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Asetet e ngrira ruse vlerësohet se arrijnë shumën prej 300 miliardë dollarësh.

Huaja është “e destinuar si mbështetje buxhetore për shpenzimet ushtarake të Ukrainës, duke u mundësuar ukrainasve të investojnë në pajisje kyçe për përpjekjet e tyre kundër Rusisë, sikurse mbrojtja ajrore, artileria dhe pajisje të

tjera”, tha Healey përmes një deklarate të publikuar nga qeveria britanike.

Kjo hua është shumë shtesë në kuadër të programit ekzistues të Britanisë për mbështetje vjetore ushtarake për Ukrainën në vlerë prej 3.9 miliardë dollarësh dhe vjen pasi Londra veçse ka dhënë 16 miliardë dollarë në formë të mbështetjes ushtarake, ekonomike dhe humanitare për Kievin.

Rusia ka thënë se përdorimi i aseteve të saj të ngrira është i paligjshëm dhe ka paralajmëruar se do të hakmerret.

# Riho Terras nga Estonia pritet të jetë raportues për Kosovën në PE

PRISHTINË, 22 TETOR - Eurodeputeti estonez nga Partia Popullore Evropian (PPE), Riho Terras, pritet të emërohet raportues për Kosovën në Parlamentin Evropian. Për emërimin e tij në këtë post duhet të pajohet grupi i PPE-së në Komisionin për Politikë të Jashtme. Por, burime të Radios Evropa e Lirë në PE thanë se Terras pritet të emërohet nga ky grup.

Më herët grupet politike në PE ishin pajtuar të ndajnë mes vete postet e raportuesve për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Tani i takon secilit grup që nga radhët e veta të emërojë një raportues për shtetin përkatës.

Grupit të PPE-së kësaj radhe i takon posti i raportuesit për Kosovën. Tradicionalisht, në 20 vjetët e fundit raportuesi për Kosovën gjithmonë ka qenë nga radhët e Grupit të të Gjellbërve. Ky grup shënoi rënie të



mbështetjes në zgjedhjet e fundit për PE të mbajtura më herët gjatë këtij viti dhe kësaj radhe ky grup do ta ketë postin e

raportuesit për Maqedoninë e Veriut.

Riho Terras është ish-ushtarak nga Estonia, i cili ka qenë deputet

edhe në përbërjen paraprake të Parlamentit Evropian.

Raportues për Serbinë në PE do të jetë deputeti socialdemokrat

nga Kroacia, Tonino Picula. Ai veçse e ka bërë publike emërimin e tij në këtë post.

Ndërkaq, për Shqipërinë, raportues pritet të jetë Andreas Schieder nga socialdemokratët. Për Maqedoninë e Veriut pritet të jetë deputeti i të Gjellbërve, Thomas Waitz, nga Austria si dhe deputeti liberal nga Sllovenia, Marjan Sharec, pritet të jetë raportues për Malin e Zi.

Nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, vetëm për Bosnjë-Hercegovinën nuk dihet se kush do të jetë raportues në PE.

Raportuesit e rinj për pesë vjetët e ardhshëm do të ndjekin nga afër zhvillimet në vendet përkatëse dhe do të përpilojnë raportet vjetore. Përmes këtyre raporteve do të vlerësohet përparimi i këtyre shteteve në procesin e reformave dhe përmbushjes së kriteve për integrim në BE.

## Vetëm 39 % e rekomandimeve të Auditorit janë zbatuar nga komunat e Kosovës në vitin 2023

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Transparency International Kosova (TIK) në një konferencë për medie kanë publikuar analizën gjithëpërfshirëse mbi përsëritjen dhe nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve të dala nga raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit ZKA për 12 komuna të Kosovës: Ferizaj, Graçanicë, Gjakovë, Kaçanik, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Podujevë, Rahovec dhe Skenderaj. Analiza gjithëpërfshirëse ofron një pasqyrë të performancës së komunave bazuar në opinionet e përgjithshme të ZKA-së, llojin e gjetjeve dhe nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve.

Drejtori i KDI-së, Ismet Kryeziu, tha se qëllimi i këtij raporti është që të dihet se çfarë po ndodh me menaxhimin e parasë publike. Ai sqaroi se, sipas raportit të vitit 2023, të gjitha komunat e Kosovës kanë zbatuar vetëm 39 për qind të

rekomandimeve të Auditorit. "Duke parë së të gjeturat tona kanë një nivel të ulët të respektit të rekomandimeve që dalin nga ZKA-ja, këtë diskutim e kemi organizuar që të shohim se nëse është mungesë e kapaciteteve të komunave, apo është mungesë e politikave afatgjatë. Sipas raportit vjetor 2023, vetëm 39 për qind e rekomandimeve të Auditorit janë zbatuar", ka thënë ai.

Selviye Kurti, menaxhere e projektit në KDI, tha se, sipas raportit, ka përqendrim të menaxhimit të parasë publike nga komunat. Ajo ka thënë se gjetjet kyçe të përsëritura në 12 komunat e Kosovës janë menaxhimin i dobët të pronave publike, nënshkrimin e kontratave pa fonde të miratuara, kontrollin e dobët mbi projektet, sfidat në prokurimin publik, subvencionimin parespektuar procedurat ligjore, dhe një zbatim të dobët të rekomandimeve të auditimit.

Kurti tha se vetëm 33.3 për qind nga 12 komunat kanë marrë një opinion të pamodifikuar apo pozitiv, ndërsa pjesa dominuese



prej 66.7-përqindësh e komunave kanë marrë opinion të modifikuar apo negativ për vitin 2023 ku, sipas saj, tregon për mangësi dhe parregullsi në raportet e tyre financiare. "Raporti i punës së ZKA-së për vitin 2023 tregon se përmbushja e rekomandimeve të auditorit nga komunat mbetet

sfiduese, me një shkallë zbatimi prej vetëm 39 %, që është më e ulët krahasuar me vitin 2022, ku zbatimi i rekomandimeve kishte arritur në 46 % për 34 komuna. Sipas ZKA-së, edhe numri i opinionëve të modifikuara-kualifikuara për komunat për vitin 2023 ishte më i lartë se në vitin 2022, pra nga 16

kishte arritur në 23 në nivel vendi. Ky fakt tregon për përqendrim të performancës së komunave lidhur me menaxhimin e financave publike lokale, përkatësisht saktësisë financiare dhe atë të pajtueshmërisë në nivel vendi", ka thënë Selviye Kurti, menaxhere e projektit në KDI.

## Bislimi takon ambasadorin e Italisë, kërkon largimin e masave ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës

PRISHTINË, 22 TETOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Antonello De Riu. Gjatë takimit u diskutua mbi marrëdhëniet dypalëshe dhe mundësitë për thellimin e

tyre. Integrimi evropian i Kosovës ishte në fokus të bisedës, ku zëvendëskryeministri theksoi angazhimin e vendit në kuadër të Planit të Rritjes si dhe rëndësinë e ecjes përpara në hapa me aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Më tutje zëvendëskryeministri



nënvizoi dhe nevojën për heqjen e masave ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës, të cilat vijojnë të jenë të padrejta e të mbeten në fuqi edhe pas konstatimit të përfaqësuesit të lartë të BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Josep Borrell, në raportin e tij, ku rekomandon që masat duhet të hiqen.



## O'Brien: Asociacioni nuk krijon një shtresë tjetër të pushtetit në Kosovë

Ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, gjatë vizitës së tij në Prishtinë, ka thënë se pret nga Kosova ta dërgojë projekt-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa theksoi se ky mekanizëm nuk krijon një qeverisje apo një shtresë tjetër të pushtetit

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 TETOR - Raportet e Kosovës me Serbinë, përparimi në dialogun mes dy vendeve dhe nevoja për dorëzim të Millan Radoçiçit në Kosovë, kanë qenë disa prej çështjeve që kanë diskutuar një ditë më parë ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në Prishtinë, sipas Qeverisë së Kosovës.

Në një komunikatë të lëshuar për medie, qeveria e ka përmendur nevojën e nënshkrimit të Marrëveshjes Bazë të arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë një vit më parë në mënyrë që ajo të respektohet dhe zbatohet. Ndërkaq Kurti ka shkruar në "Facebook" se me

ndihmësekretarin për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike të Departamentit të Shtetit amerikan, James C. O'Brien, kanë diskutuar për më shumë se dy orë për marrëdhëniet dypalëshe dhe për fushat në të cilat mund të thellohen edhe më shumë raportet e ngushta ndërmjet dy vendeve, pastaj për bashkëpunimin rajonal dhe për Marrëveshjen Bazë dhe aneksin e zbatimit të cilave po i shmanget Serbia duke mos i nënshkruar dhe shkelur ato vazhdimisht. "Shteteve të Bashkuara të Amerikës i jemi gjithmonë mirënjohës për rolin historik dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj Republikës së Kosovës dhe popullit tonë, dhe për bashkëpunimin e afërt që kemi në sektorë kyç për zhvillimin e vendit, si ai i energjisë, ekonomisë, financave, sigurisë e mbrojtjes", ka

shkruar Kurti.

Marrëveshja për normalizim marrëdhëniesh është arritur mes dy vendeve në shkurt të 2023-s në Bruksel, më pas palët janë pajtuar për një aneks në Ohër të Maqedonisë së Veriut, por nuk janë bërë hapa drejt zbatimit. Sa i përket ekstradimit të Radoçiçit, ish-nënkryetarit të Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit - qeveria ka vlerësuar se dorëzimi i tij i shërben ligjshmërisë, drejtësisë, paqes dhe sigurisë.

Radoçiçi e ka marrë përgjegjësinë për organizim dhe kryerje të sulmit në Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit të kaluar, në të cilin është vrarë rreshteri Afrim Bunjaku.

Në shkëmbim e sipër të zjarrit janë vrarë edhe tre sulmues serbë. Kosova e fajëson shtetin serb për organizim të sulmit, por Beogradi zyrtar mohon gjithçka.

Autoritetet drejtësisë kanë ngritur aktakuzë për këtë rast kundër Radoçiçit dhe dhjetëra personave të tjerë, tre prej të cilëve janë të arrestuar në Kosovë.

Radoçiçi dhe të tjerët besohet se janë të lirë në Serbi.

O'Brien ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë më

shumë diskutime para se të marrë një vendim dhe se për këtë arsye linden, me raste, mospajtimet në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara.

Në një intervistë për televizionin lokal "Kanal 10", O'Brien ka thënë se Kosova duhet ta shfrytëzojë tregun e përbashkët rajonal dhe mundësitë e tjera që ka përpara për t'u zhvilluar sa më shumë në të mirë të qytetarëve. Sipas tij, rruga përpara për Kosovën dhe Serbinë, drejt integriteteve evropiane, është vetëm duke zbatuar Marrëveshjen Bazë, të arritur mes vendeve vitin e kaluar. I pyetur nëse vendet do të sanksionohen nga ShBA-ja për moszbatim të Marrëveshjes, ai ka thënë se sanksioni kryesor për to është që humbin mundësi të mëdha për qytetarët e tyre nga moszbatimi.

Në linjë me zbatim të Marrëveshjes Bazë, O'Brien ka thënë se është edhe çështja e dërgimit të draftit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Zyrtari amerikan ka thënë se qytetarëve duhet t'u sqarohet se Asociacioni është vetëm një platformë që komunat të shkëmbejnë përvoja, që në

Evropë ekzistojnë rreth 400 asociacione të tilla, dhe që në rastin e Kosovës nuk nënkupton një nivel të ri të qeverisjes. "Por është një mekanizëm për bashkërenditje, siç e shohim në Italinë Veriore apo në ishujt e Suedisë apo në Belgjikë", ka thënë O'Brien.

Që nga viti 2013 Kosova dhe Serbia janë pajtuar për themelimin e Asociacionit. Më 2015 është arritur edhe Marrëveshja mbi parimet për themelimin e këtij asociacioni, por marrëveshjet nuk janë zbatuar kurrë. Kosova ka shprehur drojtjen se një asociacion i tillë njëetnik mund të ndikojë në funksionimin e shtetit.

Lidhur me sulmin në Banjskë, O'Brien ka thënë pret që Radoçiçi të ndiqet penalisht, dhe që ShBA-ja vëren se Serbia ka ndërmarre veprime për të parandaluar akte të dhunës në periudhën pas sulmit. Para vizitës në Prishtinë, O'Brien kishte vizituar Beogradin dhe është takuar me presidentin serb Aleksandar Vuçiq.

Pas këtij takimi, lideri serb ka thënë se takimi me zyrtarin amerikan është fokusuar në "zgjdhjen politike në rajon, në situatën aktuale në Kosovë dhe forcimin e bashkëpunimit në shumë fusha".

## Kontratrat sociale, Asociacioni i Komunave vazhdon projektin me USAID-in

PRISHTINË, 22 TETOR - Asociacioni i Komunave të Kosovës ka vazhduar projektin me USAID-in për mbështetje të komunave si vazhdimësi e projektit të Aktivitetit të Kontratës Sociale.

USAID ka miratuar "Planin për monitorimin dhe mbështetjen e komunave", duke siguruar

vazhdimin e bashkëpunimit tonë të ngushtë me Asociacionin e Komunave të Kosovës për dy vitet e ardhshme.

Ky projekt përfshin një angazhim të shtuar për forcimin e kapaciteteve të komunave dhe përmirësimin e qeverisjes në nivel lokal në

përputhje me objektivat e përgjithshme të zhvillimit demokratik të vendit.

Qëllimi ynë është që praktikat e paraqitura nga Aktiviteti i Kontratës Sociale të USAID-it të bëhen pjesë e përhershme e punës institucionale të komunave, duke përfshirë një fokus të veçantë në zgjerimin e

procesit të buxhetimit pjesëmarrës.

Kjo nismë do ta lehtësojë përfshirjen më të madhe të qytetarëve në vendimmarrje, duke u mundësuar komunave t'i planifikojnë dhe menaxhojnë më mirë burimet e tyre në përputhje me nevojat dhe prioritetet e komunitetit.



# Kandidatët e KE-së në seanca dëgjimore, pyetje edhe për Kosovën

PRISHTINË, 22 TETOR - Derisa pjesa më e madhe e botës pritet të përqendrohet në zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara dhe rezultatet e tyre, Bashkimi Evropian do të jetë i zënë me krejt diçka tjetër: seancat dëgjimore për 26 komisionarët janë caktuar nga data 4 deri më 12 nëntor.

Secili kandidat për tri orë do të përballet me pyetjet e anëtarëve të Parlamentit Evropian në një komitet që lidhet me portofolat e tyre.

Herën e fundit, më 2019, tre kandidatë nuk kanë kaluar. Diçka e ngjashme mund të ndodhë përsëri dhe të çojë në seanca shtesë dëgjimore gjatë nëntorit. Ajo që pritet të kalojë është shefja e pritshme e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas. Ish-kryeministrja e Estonisë konsiderohet si një nga "yjet" e ekipit të ri të presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Ajo që do të jetë interesante në seancën e saj të 12 nëntorit është të shihet nëse dhe sa do ta zbusë retorikën e saj të ashpër ndaj Kinës dhe Rusisë, për t'iu përshtatur postit të ri, ku diplomacia dhe gjetja e konsensusit për çështjet e politikës së jashtme janë shumë të rëndësishme.

Gjykuar nga letra e misionit të Von der Leyenit drejtuar Kallasit, pjesa më e madhe e pyetjeve do të jetë për Ukrainën.

Në letërën e misionit - që është një dokument publik që përshkruan atë që presidentja pret nga një komisionar gjatë pesë vjetëve të ardhshëm - thuhet: "Ne do të

punojmë ngushtë së bashku, për të siguruar se Evropa qëndron me Ukrainën për aq kohë sa i duhet - ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht - dhe mbështet integritetin e saj territorial".

## A mund të ofrojë Kallas diçka të re këtu?

Kievi pritet t'i hapë kapitujt e negociatave të anëtarësimit në BE vitin e ardhshëm dhe mbështetja financiare e BE-së për Ukrainën, për vitin 2025, është siguruar.

Deri më tani BE-ja ka ndërmarrë 14 raunde sanksionesh kundër Rusisë por, sipas diplomatëve në Bruksel, po bëhet gjithnjë e më e vështirë që vendet anëtare të binden për të miratuar masa shtesë kundër Moskës.

Ndaj do të jetë interesante të shihet nëse Kallas do të marrë një qëndrim më të ashpër - për shembull - duke parandaluar anashkalimin e sanksioneve me shtimin e kompanive të vendeve të treta apo edhe vende të treta në listën e zezë të BE-së.

BE-ja ka mekanizma për ta bërë këtë, por listat, deri më tani, kanë mbetur bosh.

Nëse miratohet - dhe çështja është kur dhe jo nëse - Kallas ka të ngjarë të paraqesë një regjim të ri sanksionesh, që do t'i ketë në shënjestër kërcënimet hibride ndaj BE-së.

Një regjim i ri që merret me veprimet subversive ruse ndaj bllokut është miratuar së voni, por Kallas pritet të shtyjë përpara një mekanizëm global.

Shumë eurodeputetë sigurojnë se do ta nxisin Kallasin që ta përfshijë



korruptionin si një vepër të sanksionueshme në "Aktin Magnitsky" të BE-së, i cili përcakton sanksione për shkelësit e drejtave të njeriut në Rusi.

Kjo është diçka që është shmangur nga shefat e mëparshëm të politikës së jashtme të BE-së dhe ata që e mbështesin një masë të tillë, shpresojnë se ajo do të nënkuptojë shfrytëzimin e aseteve të ngrira ruse në BE, për ta paguar rindërtimin e Ukrainës.

Të dyja këto lëvizje kërkojnë unanimitet dhe do të jetë detyrë e Kallasit për ta realizuar atë.

Si Von der Leyen, ashtu edhe Parlamenti Evropian duan që Kallas të përpikët të marrë më shumë vendime të politikës së jashtme të BE-së me votim nga shumica.

Ndoshta aspekti më kurioz i letrës së misionit të Von der Leyenit është se ajo nuk përmend Ballkanin Perëndimor apo Kinën, por eurodeputetët me siguri se do ta pyesin atë për të dyja.

Ka gjasa që ajo të njoftojë në seancë dëgjimore se udhëtimi i saj

i parë si komisionare do të jetë në Ballkanin Perëndimor. Sa i përket këtij rajoni, ajo me siguri se do të pyetet se si synon ta ringjallë dialogun Prishtinë - Beograd, të ndërmjetësuar nga BE-ja. Paraardhësit e saj, Federica Mogherini dhe Josep Borrell, nuk arritën shumë në marrëdhëniet Kosovë - Serbi gjatë dhjetë vjetëve të fundit.

A do të ketë Kallas një qasje më praktike me takime të rregullta me udhëheqësit e dy vendeve, apo do t'ia delegojë bisedimet ndonjë përfaqësuesi të posaçëm, siç ka bërë Borrelli?

BE-ja ka vendosur së voni tarifa për automjetet elektrike kineze dhe Kallas ka të ngjarë të pyetet nëse ajo ka sektorë të tjerë në planet e saj. Ajo, gjithashtu, do të jetë nën presion për të treguar nëse do ta përndjekë Kinën, po qe se ajo vazhdon ta ndihmojë luftën e Kremlinit në Ukrainë.

Pasi që seanca dëgjimore zhvillohet një javë pas zgjedhjeve në ShBA, pritet të ketë pyetje edhe për marrëdhëniet e ardhshme me

Washingtonin, sidomos nëse Donald Trumpi kthehet në Shtëpinë e Bardhë.

Kallas, sipas njerëzve që e njohin, i mbështet fuqishëm marrëdhëniet transatlantike, por ajo do të pyetet për nevojën që BE-ja të zhvillojë një lloj "autonomie strategjike" - një koncept ky që shumë në pjesën lindore të bllokut e shohin si një plan të Francës për ta zvogëluar ndikimin e ShBA-së dhe për të ngritur të vetin.

Një nga detyrat e saj kryesore, së bashku me portofolin e sapokrijuar të mbrojtjes - që i është dhënë ish-kryeministrit lituanëz Andrius Kubilius - do të jetë hartimi i një 'letre të bardhë' për të ardhmen e mbrojtjes evropiane në 100 ditët e para të mandatit të saj.

Si gjithmonë, pyetja prej një milion dollarësh është se sa para duhet të jepen për të ndërtuar një industri evropiane të mbrojtjes - plus, nëse BE-ja do të punojë me kontraktorë të mbrojtjes jashtë BE-së?

Dhe pastaj, natyrisht, është kriza në Lindjen e Mesme. Me shtetet anëtare të ndara sa i përket Izraelit, është e qartë se BE-ja nuk ka shumë dëshirë ta formësojë situatën tani.

Por, sapo të qetësohet pluhuri, ka thirrje për një plan të fortë. Siç thuhet në letërën e misionit: "Ju do të çoni përpara një strategji gjithëpërfshirëse të BE-së për Lindjen e Mesme, me plane pas luftës në Gazë, duke u fokusuar në promovimin e të gjithë hapave të nevojshëm për zgjidhjen me dy shtete dhe forcimin e partneriteteve me aktorët kryesorë rajonale".

## Reagim i KMDLNJ-së

# E sulmojnë Ramën, vetë nënshkruan marrëveshje kriminale me Danimarkën

Italia dhe Shqipëria nënshkruan një marrëveshje për strehimin e refugjatëve, kryesisht nga Afrika dhe Azia, para se ata të kthehen në vendet e origjinës. Këto kampe më shumë janë burgje se kampe për refugjatë në përputhje me standardet ndërkombëtare, prandaj është kritikuar nga aktivistë për të drejtat e njeriut, brenda dhe jashtë Shqipërisë, shkaku se shkelë të drejtat e njeriut. GjND e ka refuzuar këtë marrëveshje sikur edhe Gjykata në Romë duke urdhëruar që refugjatët e vendosur në këtë kamp të kthehen në Itali.

Kuvendi i Kosovës, me propozim të qeverisë së Kosovës ka votuar një marrëveshje kriminale me Danimarkën për trafikim me qenie njerëzore duke transferuar, kundër vullnetit të tyre, 300 të burgosur me rrezikshmëri të lartë nga Danimarka në burgun e Gjilanit. Asnjëri prej tyre nuk është danez por nga vendet e treta, kryesisht të besimit Islam.



Presioni për ta votuar këtë marrëveshje ishte i madh nga pushteti aktual ndonëse marrëveshje ishte kritikuar ashpër nga Komiteti Kundër Torturës dhe Trajtimin Degradues i Kombeve të Bashkuara që kishte kërkuar anulimin e saj shkaku se

shkelë të drejtat e njeriut. Po të ishte Kosova anëtare e Kombeve të Bashkuara apo e Këshillit të Evropës, kjo marrëveshje sigurosh nuk do të kalonte.

Ministrja e Drejtësisë e Kosovës ka mashtruar deputetët e Kuvendit të Kosovës sikur edhe opinionin

duke mos e treguar të vërtetën për të burgosurit nga "Danimarka", nga vijnë, përkatësia kombëtare dhe e besimit, natyra e veprave penale, shkalla e rrezikshmërisë dhe të dhëna të tjera që kanë rëndësi për sigurinë e vendit. Ministrja e Drejtësisë ka heshtur

çdo kundërshtim brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës sikur që ka ndërtuar raporte klienteliste me OJQ-të që eventualisht do të kundërshtonin këtë marrëveshje.

Nga vendet e rajonit vetëm Shqipëria dhe Kosova kanë pranuar të nënshkruajnë marrëveshje që përmbajtësisht e rrezikojnë integritetin, sigurinë dhe sovranitetin e vendit. Ministrja e Drejtësisë e Kosovës duhet të përgjigjet para ligjit për nënshkrimin e marrëveshjes, skajshmërisht të dëmshme për Kosovën sepse legalizon dy sisteme korrektuese dhe dy ligo të kundërta për ekzekutim të sanksioneve penale duke ndarë të burgosurit në të superprivilegjuar (nga Danimarka) dhe super të diskriminuar nga Kosova.

Është shumë e pamoralshme dhe jonjerëzore të kritikohet marrëveshja e Ramës me Italinë dhe të përkratet marrëveshja e Albulena Haxhiut me Danimarkën.

# Diplomacia e Kosovës dështoi aty ku nuk duhej e ku ishte më e fortë



Shkruan: Hajdin ABAZI

Dje, në të njëjtën ditë, u publikuan dy deklarata interesante, sado që kontroverse me njëra-tjetrën, por që nxirrnin në suprinë atë që zyrtarisht Kosova përpiqet ta injorojë.

Njëra deklaratë erdhi nga ministrja e Punëve të Jashtme, zonja Donika Gërvalla-Schwarz, e tjetra nga ndihmëssekretari amerikan i shtetit, James O'Brien.

Ndonëse në të dyja rastet fokusi ishte te Kosova, njëra alegorikisht linte të nënkuptohej se ishte nxjerrë mësimi i duhur nga historia, kurse tjetra deklaratë ishte një kritikë, dorën në zemër, jo e re, e përsëritur, por në një kontekst tjetër.

\*

Deklarata e drejtueses së diplomacisë kosovare u bë në ceremoninë e 10-vjetorit të Akademisë Diplomatike.

Ajo, ndër të tjera, tha: "Historia jonë është dëshmi që përkujton se sa e fuqishme dhe e rëndësishme është diplomacia si një përgjigje ndaj krizave dhe për t'i ndaluar ato. Diplomacia është çelësi i zgjidhjeve të krizave, mbrojtja e nderit të njerëzve, dhe stabilitetit".

Kjo është, pa fije dyshimi, e vërtetë. Asnjë fjalë nuk ka çka i hiqet. E tëra është ashtu. Dhe ishte aq e saktë, sa e lexova edhe një herë se kush e ka thënë sepse diçka nuk shkonte.

E rikonfirmova kështu se njëmend e kishte thënë ajo që mban postin e kryediplomates, vetë ministrja Donika!

E pabesueshme, por e vërtetë. Ani çka nuk shkon këtu? Ku është problemi?

Ka vetëm një gjë: këtë po e thoshte një ministër në krye të asaj diplomacie të shtetit tonë, që nuk ka arritur as dhe një sukses për të thënë pikërisht në diplomaci.

E ka thënë ajo që me të ardhur në pushtet u dakordua me kryeministrin dhe presidenten

për ta goditur - pikërisht diplomacinë! Dhe e goditi rëndë: me qasje nihiliste, për interesa partiake, pa analiza, pa procedura, pa vlerësime dhe pa asnjë selektim, largoi ambasadorë e diplomatë.

Goditje me e madhe nuk i ishte dhënë diplomacisë, që prej se ishte themeluar në vitin 2008. Dhe kjo i ka dërguar qysh atëherë sinjale botës se po amortizohet e paralizohet diplomacia e Kosovës, ndërkohë që diplomacia serbe ishte në aksion full fart kundër Kosovës.

## Rrjedhoja?

Në vend të fokusit në diplomaci aktive, sensibilizuese e lobuese, diplomacia e ministres Donika preokupohej me rekrutimin e stafit, gjë që mori shumë kohë, sa që duket sikur ende nuk e ka marrë veten nga ajo "fshesë pamendësie".

## Rezultati?

Pikërisht në sferën diplomatike Kosova i mori goditjet që veç Serbia mund t'i dëshironte dhe që veç asaj i shkonin për shtati, goditje që erdhën si pasojë e veprimeve gjoja për të ndryshuar qasjen, për t'u dalluar nga qeveritë e kaluar dhe për të demonstruar mundësinë abuzuese të pushtetit. Por për këtë u zgjodh fusha më e gabuar - diplomacia. Mund të dallohesh nga e kaluara dhe për të ndryshuar qasjen, kur ke një plan, një vizion, një strategji dhe kur i ke bërë parapërgatitjet. Në vend të kësaj, kryediplomatja, kryeministri e presidentja vepruan partizantqë: "a mundemi, e bëjmë".

Ajo që erdhi më pas që një degradim i raporteve me aleatët strategjik, në radhë të parë ShBA. Nuk vonoi edhe me BE nisën kundërshtimet. Për shkak të veprimeve me rrezik për eskalim konflikti midis Serbisë e KFOR-it e në instancë të fundit vendeve euroatlantike e që ishin në kundërshtim me gjeostrategjinë ShBA-BE, Kosovës iu vunë sanksione.

Kjo gjendje është ende aktuale: Kosova ndodhet nën sanksione, ani se ato po quhen masa.

Nuk e di se me çka mund të krenohet kryediplomatja në

diplomacinë e Kosovës nën udhëheqjen e saj?

Ose të paktën, një sukses relevant të vetëm në këto katër vite?

Nuk besoj të jetë aq e lajthitur sa ta konsideroj si sukses thujta largimin nga Procesi i Berlinit, sa e bënë shtetin prej nga vjen ajo, Gjermaninë, të kërcënojë hapur Kosovën me izolim!

Aferat korruptive e skandalet janë çështje tjetër që nuk po merrem me to kësaj here. Gabimet e së kaluarës ministre nuk mund të zhbëhen, ato po i vuan Kosova dhe t'i duhet t'i kesh peng në ndërgjegje!

\*

Deklarata tjetër, ajo e James O'Brien, Ndihmës Sekretar Amerikan i Shtetit për Çështjet Europiane dhe Euroaziatike.

Ai e tha troç: "... se a janë gjërat të koordinuara apo jo... unë kam folur publikisht se sjellja e Prishtinës për t'u mos u koordinuar me ne dhe NATO-n nxit dyshime se ajo qeveri më shumë është e interesuar për të treguar fuqi se sa për të mundësuar jetë normale", tha O'Brien në një intervistë për RTS-në në Beograd.

O'Brien po e thotë hapur se Qeveria e Kurtit nuk po koordinohet me ShBA dhe me NATO-n lidhur me veprimet në veri. Dhe për këtë kurrë kryediplomatja nuk ka pasur një qëndrim të saj, për t'u distancuar ose për t'u dalluar, por në heshtje ka pranuar politikën e kryeministrit të cilat kishin shumë implikime. Ajo nuk mundet të dalë, nga asnjë pozicion, e të thotë se ka vepruar ndryshe ose ka insistuar ndryshe. Në fund të fundit, duhet pasur pak dinjitet: nëse njëmend nuk pajtohesh, nuk është kiamet e as fundi i botës të japësh dorëheqje për një çështje kaq të madhe.

Veprimet e pakoordinuara me ShBA dhe NATO, sikurse po e thotë O'Brien, ishin me pasoja lokale po se po; por, sikurse e kam thënë më parë, ato ishin veprime me frekuenca minuese te gjeostrategjisë ShBA-BE-NATO: një konflikt në veri do t'i konvenonte vetëm Rusisë e edhe Vuçiqit, por kurrsesi gjeostrategjisë perëndimore dhe aspak Kosovës.

Dhe O'Brien e thotë një

vlerësim që më tepër është një akuzë: Qeveria e Kosovës

më shumë është e interesuar për të treguar fuqi se sa për të mundësuar jetë normale".

Ç'domethënë kjo? Kosova e interesuar të tregojë fuqi, por në mënyrë të gabuar e bënë këtë. Sado të armatoset Kosova nuk mundet t'ia kalojë Serbisë e cila ka industri të armatimit dhe po ashtu blen me miliarda euro armë të sofistikuar, pra nuk mundemi (në gjendjen e tashme) të bëhemi fuqi ushtarake sa të frikësohet nga ne Serbia.

Fuqia e vërtetë e Kosovës nuk qëndron te ushtria dhe armatimi (sigurisht nga kjo nuk rrjedhë se nuk duhet të kemi ushtri dhe të armatosemi). Jo. Forca jonë qëndron te fakti se në Kosovë është NATO-ja e dislokuar dhe ka përgjegjësinë e sigurisë së kufijve tanë. Fuqia e vërtetë e Kosovës është vetëm sinergia me ShBA dhe NATO, kontributi ynë në gjeopolitikën euroatlantike dhe te konstruktiviteti ynë duke u koordinuar për gjithçka. Ne duhet të jemi me fat që ShBA e NATO janë të gatshme të na ofrojnë mbështetje, dhe të na tregojnë se kur duhet vepruar e kur jo, që mos t'u japim atë pretekst që e kërkojnë luftënxitësit në Ballkan.

Duhet të përjetohet si një shuplakë për qeverinë: "nuk është e interesuar për jetë normale" në veri dhe me minoritetin serb. Këtë nuk po e thotë Vuçiqi, as opozita e as kritikuesit tuaj, por po e thotë O'Brieni. Dhe kjo demanton të gjitha pretendimet e qeverisë Kurti 2 se gjoja është përmirësuar gjendja në veri.

Dhe më tej, zhveshja e farsës diplomatike të Kosovës: "ka disa pasoja për Kosovën, më e madhja ishte që vende të mëdha të Evropës nuk votuan që Kosova të inkuadrohet në institucionet e tyre. Kosova mbetet mbrapa krahasuar me vendet tjera ballkanike. Krejt kjo ndodh për arsye se ata marrin disa vendime të pakoordinuara". Një diplomaci e Kosovës që nuk koordinohet me ShBA dhe NATO, dhe këtë tash po e thotë O'Brien, njëlloj sikurse e thoshte edhe Escobar. Krejt deklaratat se mirë i kemi punët me ShBA dhe me NATO, u demantuan, u përgënjeshtroan.

Në vend se të forcoheshin raportet e ndërsjella me ShBA dhe me NATO, si një vazhdimësi e shumë dekadave, mësimi që është nxjerrë nga "historia jonë" nuk është ajo që tha kryediplomatja, por e kundërta: ftohja, zvetëni, refuzimi deri te moskoordinimi. Më shumë se kaq, nuk mund të shkonte mbrapshtia politike e as diplomatike.

Dhe a mund të merret me mend, se ku do të përfundonte Kosova, sikur të hiqte dorë ShBA dhe NATO nga Kosova?

Është koha e fundit që kryediplomatja dhe kryeministri të reflektojnë dhe të kthehen në sinergjinë me ShBA dhe me NATO, të sinkronizimit për gjithçka.

Ardhja e drejtorit të CIA-s e ndali marrëzinë politike të Kurtit për hapjen e urës së Ibrit pa koordinim me ShBA e NATO që do të ishte një debakël shtetëror e diplomatik, sepse Vuçiqi e kishte planin me gënjeshtër për "eksodin serb" nga Kosova, që me veprimin e pakoordinuar sikurse përgatitej të veprohej, do t'i ngjante së vërtetës dhe do t'i shërbente si një pretekst fenomenal që as peshku i artë nuk do të mund t'ia dhuronte.

Edhe biseda e O'Brien do të duhej ta bënte edhe Albinin e edhe Donikën të kuptonin se në konstelacionet e tashme gjeopolitike e gjeostrategjike globale kur luftërat po shpërthejnë gjithandej, dhe Serbia nxit e i frynë zjarrit, nuk mundet kryeministri si knus në kerr të kokoriset si të dojë e kryediplomatja t'ia mbajë izon, po se duhet sinkronizuar detajisht me ShBA dhe NATO.

Po cili është roli i kryediplomates në këtë mes, që thotë se ka nxjerrë mësim nga historia e Kosovës, përveçse ke bërë deklaratat ndonjëherë kontroverse e ndonjëherë edhe fyese? E di se është e vështirë ta pranosh, por ty ndoshta do të të kishte shkuar disi posti i ministres së Kulturës, sepse posti i diplomacisë të ka ngecur në fyt, sepse e ke bërë të dështojë diplomacia e Kosovës aty ku ishte e fortë dhe ku e ka forcën shtytëse çdo sukses yni në tri-katër dekadat e fundit: raportet bashkërenduese me ShBA-në, para së gjithash, por edhe me NATO-n.

## Policia gjen mbi 10 kilogramë drogë në magjistralen Fushë Kosovë - Prishtinë

PRISHTINË, 22 TETOR - Policia e Kosovës tha se gjatë një operacioni ka ndaluar një automjet me targa të Kosovës në magjistralen Fushë Kosovë - Prishtinë, në të cilën ka gjetur mbi 10 kilogramë drogë, që dyshohet se është e llojit kokainë.

Sipas njoftimit, shtetasi i Kosovës Z. J. po drejtonte automjetin në të cilin u gjet droga prej 10 kilogramë e 224 gramësh në vlerë të tregut prej

450.000 eurosh.

Ai është ndaluar për 48 orë dhe ndaj tij është iniciuar rasti për veprën penale: "blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve - substancave psikotrope dhe analoge".

Policia tha se pasi gjeti drogën në veturën e të dyshuarit, kreu edhe bastisje në shtëpinë e tij në komunën e Graçanicës, që gjendet afër Prishtinës.

Gjatë këtij aksioni, të koduar

"007", Policia sekuestroi edhe një veturë me targa të Kosovës, 1 445 euro, 8 970 dinarë dhe dy telefona celularë.

Po ashtu, Dogana ka sekuestruar edhe 17 kartela grafike për prodhimin e kriptovalutave.

Që nga viti 2022, kur Kosova u përball me krizë energjetike, në Kosovë është ndaluar mihja e kriptovalutave. Por, autoritetet vazhdimisht konfiskojnë pajisje që përdoren për prodhimin e tyre.



## ARKEP autorizon Starlinkun për të ofruar shërbime në Kosovë



PRISHTINË, 22 TETOR - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Kosovë (ARKEP) e ka autorizuar kompaninë amerikane Starlink për ofrimin e qasjes në internet në çdo lokacion të Kosovës. "Në të gjithë globin Starlink u ka mundësuar komuniteteve në nevojë të kenë qasje në arsim, shërbime shëndetësore, të mundësojnë punën në distancë dhe të ofrojnë mbështetje kritike të komunikimit gjatë fatkeqësive natyrore ose raste tjera të emergjencave kombëtare", është thënë në njoftimin e ARKEP-it, duke shtuar që hyrja e kësaj kompanie globale në tregun vendor do të ndikojë edhe në përfitime ekonomike dhe zhvillim të përgjithshëm të Kosovës.

Starlink është rrjet privat satelitor i internetit që zotërohet prej kompanisë SpaceX të miliarderit Elon Musk.

Starlink besohet se i ka rreth 4 800 pajisje në orbitë, përmes të cilave ofrohet internet në rreth 100 vend të botës.

Musk pati vendosur t'i ofrojë qasje Ukrainës në këtë rrjet, pas nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, në shkurt të vitit 2022, si pasojë e së cilës shteti pati mbetur pa linja komunikimi.

Starlinku përdoret nga miliona njerëz në gjithë botën, pasi ofron internet më të shpejtë sesa disa ofrues vendorë.

Në faqen zyrtare të kompanisë mjafton ta kërkon adresën më të afërt dhe aty më pas duhet kryer pagesën për ta marrë shërbimin.

## Për gjashtë muaj mbi 60 mjekë e lëshuan Kosovën

PRISHTINË, 22 TETOR - Mbi 60 mjekë e kanë lëshuar Kosovën në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti, ndërsa rrezikohet që institucionet shëndetësore sekondare dhe ato terciare brenda pak viteve të mbesin pa profesionistë shëndetësorë.

Faktorët që po kontribuojnë në këtë fenomen përfshijnë papunësinë, mungesën e investimeve në infrastrukturën ligjore, kushte të papërshtatshme pune dhe cilësinë e ulët të shkollimit specialistik.

Kështu ka thënë kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës, Pleurat Sejdiu, në një intervistë për "Kosovapress", derisa ka potencuar se dallojnë

arsyet e largimit të mjekëve nga Kosova në vitin 2023 dhe këtë vit.

Sejdiu ka theksuar se brenda dy apo tri viteve do të vërehet dukshëm mungesa e mjekëve në nivelin sekondar dhe atë terciar.

Përveç trendit të braktisjes së vendit të punës, ai ka treguar se këtë vit do të pensionohen rreth 100 mjekë.

Sejdiu ka thënë se mungesa e furnizimit me barna dhe materiale, salla operative si dhe mungesa totale e një sistemi shëndetësor janë disa nga sfidat me të cilat përballen mjekët në Kosovë.

Gjatë vitit 2023 rreth 170 mjekë kanë lëshuar vendin e tyre të punës në Kosovë për të dalë jashtë vendit.



## Rama inspekton punimet në tunelin e Kurrizit

Prishtinë, 22 tetor - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, bashkë me drejtoreshën e Kulturës, Sibel Halimi, kanë inspektuar punimet në tunelin e Kurrizit, pjesë e rigjenerimit urban të kryeqytetit. Ai ka thënë se ky projekt do ta përmirësojë qarkullimin dhe infrastrukturën ku përfshihet riorganizimi i trafikut dhe hyrjeve e daljeve në ditët e

rëndomta kur ka qarkullim të veturave si dhe në ditët kur mbahen aktivitetet; rritja e sigurisë për këmbësorë, biciklistë dhe vozitësit e automjeteve; përmirësimi i infrastrukturës së përgjithshme, përfshirë ndriçimin, largimin e ujërave atmosferike dhe largimin e gazrave të emetuara nga automjetet dhe bizneset ekzistuese, duke krijuar një

hapësirë të re për qytetarët. "Tuneli do të shndërrohet në një qendër aktive për aktivitete kulturore dhe komerciale. Do të organizohen koncerte, ekspozita dhe festivale, duke sjellë një atmosferë të re në qytet. Përveç kësaj, tregjet e fermerëve dhe panairët lokale do të bëjnë këtë zonë një pikë të rëndësishme takimi për qytetarët", ka thënë Rama.



# Pensionistët që kontribuuan pas luftës, përfundojnë me pensionin e moshës



**PRISHTINË, 22 TETOR** - Pensionistët që kanë kontribuar vetëm pas luftës në Kosovë, aktualisht mbështeten në fondet që i kanë kursyer në Fondin e Kursimeve Pensionale. Pasi t'i shpenzojnë ato - qoftë për dy, tre apo katër vjet - ata mbeten me vetëm pensionin e moshës, i cili tani është 120 euro. Kjo vlen për të gjithë pensionistët që karrierën e tyre e kanë zhvilluar pas luftës më 1999 - pavarësisht formimit të tyre arsimor.

Në mesin e tyre është edhe historiani Xhafer Osmani nga Prishtina. Ai është pensionuar në maj të këtij viti, pasi ka mbushur 65 vjet. Nga viti 1999 ka punuar vazhdimisht arsimtar i lëndës së Historisë. "Unë marr pensionin e moshës 120 euro dhe 200 euro nga kursimet e mia në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Këto 200 euro janë para të mia, që janë ndarë nga paga", thotë Osmani për "Radion Evropa e Lirë".

Në Kosovë çdo person që arrin moshën 65-vjeçare ka të drejtë për pensionin bazik apo të moshës, i cili paguhet nga buxheti i shtetit pavarësisht prej kontributeve të tij. Ndërsa në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, që njihet edhe si Trust, punonjësi dhe punëdhënësi kontribuojnë me nga 5 për qind të pagës së punonjësit, apo në total 10 për qind.

Në vitin 2003, për shembull, paga mesatare në administratën

publike ka qenë 167 euro, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, çfarë do të thotë se në Trust janë ndarë 16 euro në muaj. Me kalimin e viteve kjo ka ndryshuar.

Gjatë 25 vjetëve punë Osmani ka kursyer mbi 12 mijë euro në Trust. Pas pensionimit ka tërhequr 20 për qind të shumës dhe nga 200 euro në muaj do të marrë edhe për rreth katër vjet - më pas do të mbetet me pensionin e moshës. "Nuk jam kundër atyre që marrin pension të moshës, por duhet të ketë një kategorizim për kualifikime. Ne kemi punuar, kemi paguar taksa", thotë Osmani.

## Si shpenzohen paratë e Trustit në Kosovë?

Sipas ligjit në fuqi, nëse shumica e kursyer në Trust në moshën e pensionimit është nën 3 000 euro, ajo shumë paguhet menjëherë me një këst. Nëse shumica është më e madhe se 3 000 euro, por më e vogël se 20 000, atëherë përfutuesit i marrin nga 200 euro në muaj derisa t'i shpenzojnë krejt paratë. E kur kjo shumë është mbi 20 000 euro, përfutuesve u ndahen në muaj aq para sa të shpenzohen brenda 100 muajsh - pas kësaj periudhe mbeten me shumën e pensionit të moshës.

Trusti është themeluar në vitin 2002. Vlera e kursimeve aty, deri në shtator të këtij viti, ka arritur

në 3 miliardë euro - me mbi 430 mijë llogari aktive.

Numri i përfutuesve të pensionit nga viti 2002 deri në fund të vitit 2023 ka qenë rreth 74 mijë. Gjatë vitit 2023 kursimet e tyre kanë nisur t'i tërheqin 7 684 qytetarë. Sadik Hoxha, arsimtar i pensionuar i Gjeografisë, ka nisur t'i tërheqë kursimet këtë vit. Pas 11 vjetësh punë në një shkollë fillore në Rahovec, ai i ka mbushur 65 vjet shtatorin e vitit të kaluar dhe është pensionuar. Para nga Trusti ai do të marrë edhe rreth një vit, pasi ka kursyer rreth 6 000 euro. Pasi t'i përfundojë ato, do të marrë vetëm shumën që i takon me pensionin e moshës. "Ky është diskriminim. Unë para luftës nuk kam mundur të punoj për shkak të rrethanave në atë periudhë. Tash, të mbes me 120 euro në muaj? Kjo nuk mjafton as për gjëra elementare", thotë Hoxha për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas disa llogaritjeve të bëra nga sektori civil, shumica e pensionistëve i shpenzojnë mjetet nga Trusti brenda pak vitesh, pa i mbushur 70 vjet. Por, të gjithë duhet t'i shpenzojnë për 100 muaj, apo pak më shumë se 8 vjet. "Praktikisht, në moshën 73 vjeç e 4 muaj, ata marrin pensionin e fundit. Pas kësaj moshe mbeten vetëm me pensionin e moshës, siç e parashikon ligji", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Selatin Kllokoqi nga organizata joqeveritare Demokracia Plus.

Atdhe Hykoll, udhëheqës i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), thotë se në situatë edhe më të keqe se të pensionuarit nga sektori publik, janë qytetarët që pensionohen nga sektori privat. Ai thotë se pagat në këtë sektor kanë qenë dhe janë vazhdimisht më të vogla se në sektorin publik. Paga mesatare bruto në sektorin privat ka qenë 337 euro në vitin 2012, ndërsa në vitin 2023 ka arritur në 515 euro. Për më tepër, thotë Hykoll, në vitet e 2000-ta jo të gjitha bizneset ua kanë paguar punonjësve kontributet pensionale.

Raste të tilla ka edhe sot, sipas tij. "Shteti duhet të ofrojë mbështetje më të drejtë dhe trajtim dinjitoz për këta individë, pasi ata kanë kontribuar në ekonominë dhe buxhetin shtetëror përmes pagesës së taksave", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Në Qeverinë e Kosovës nuk iu përgjigjën pyetjes së "REL"-it se a do ta trajtojnë këtë çështje në reformën pensionale, e cila, sipas kryeministrit Albin Kurti, pritet të bëhet "gjatë mandatit të ardhshëm".

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë mbahen më 9 shkurt të vitit 2025.

Në mbledhjen e qeverisë së tij më 9 tetor, Kurti ka thënë se "finalizimi i reformës pensionale do të sigurojë që ata e ato që kanë kontribuar më së shumti për këtë vend, ta kenë edhe trajtimin

përkates e të dinjitetshëm", por nuk ka specifikuar më shumë.

## Cila mund të jetë zgjidhja?

Ndryshimet ligjore janë thelbësore për zgjidhjen e këtij problemi, thotë Kllokoqi. "Duhet siguruar që këta persona marrin pension bazuar në stazhin e punës dhe në kontributet e paguara në Trust", sipas tij. Reçica thotë, po ashtu, se reforma gjithëpërfshirëse e sistemit pensional është e domosdoshme, "për të siguruar mbrojtje dhe dinjitet për të gjithë pensionistët e ardhshëm". Qeveria e Kosovës më 7 tetor ka marrë vendim për t'i rritur pensionet për 20 për qind. Deri atëherë pensioni i moshës ka qenë 100 euro, ndërsa ato kontributpaguese kanë arritur deri në 265 euro.

Ekspertë të ekonomisë tërheqin shpesh vërejtjen se pensionet mbeten tejet të ulëta përballë inflacionit dhe rritjes së çmimeve në vend. "Më vjen të qaj me obligimin e shtetit ndaj meje", thotë për "Radion Evropa e Lirë" edukatorja e pensionuar, Sevdije Berisha, nga Suhareka.

Me 25 vjet përvojë pune vetëm pas luftës, ajo ka dalë në pension para pesë muajsh dhe tregon se në Trust i ka të kursyera rreth 12 000 euro.

## Mjetet e tërhequra nga Trusti

Personat që mbushin 65 vjet mund t'i tërheqin paratë nga Trusti për arsye invaliditeti. Mjetet mund t'i tërheqin edhe familjarët e atyre që vdesin. Vlera e shpaguar për këto kategori shkon në dhjetëra miliona euro në vit.

## Pensionistët që kanë punuar edhe para luftës

Me ligj secili qytetar i Kosovës që ka punuar 15 vjet para luftës, merr pension kontributpagues, edhe pas shpenzimit të parave nga Trusti. Pensioni kontributpagues aktualisht sillet nga 218 deri në 318 euro në muaj, varësisht nivelit të arsimimit.

## Murati udhëton për në ShBA, merr pjesë në takimet vjetore të BB-së dhe FMN-së

**PRISHTINË, 22 TETOR** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, do të marrë pjesë në takimet vjetore të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar

Ndërkombëtar të cilat mbahen në Uashington. Këto takime mbledhin ministrat e financave, guvernatorët e bankave qendrore, përfaqësuesit e institucioneve

ndërkombëtare financiare, përfaqësuesit e sektorit privat si dhe shoqërisë civile të shteteve nga e mbarë bota. Gjatë qëndrimit në Uashington ministri Murati

pritet të takojë përfaqësues nga menaxhmenti i lartë i Bankës Botërore dhe FMN-së si dhe institucioneve të tjera që marrin pjesë në këtë ngjarje.



# Gati për luftë! Të armatoset kush të mundë



Shpenzimet ushtarake globale në vitin 2023 kapën shifrën 2443 miliardë. Nuk janë armatosur vetëm superfuqitë. Të gjitha vendet po investojnë për furnizime luftime dhe armë gjithnjë e më të sofistikuara, të kërkuara nga “rendi aktual global”. Atje ku, pas Ukrainës dhe Lindjes së Mesme, konfliktet janë bërë një opion politik

Videoja e Forcave Ajrore izraelite, e publikuar në X, tregon avionët bombardues që në 27 shtator varrosën përgjithmonë kreun e Hezbollahut, Hassan Nasrallah në qendrën e tij në Beirut. Tetë F-15, të cilët u ngritën me bomba të paktën 16 mijë kilogramëshe. Nën barkun e avionit mund të shihet edhe amerikania Blue-109, një pajisje anti-bunker me telekomandë që depërton në vendstrehimet e betonit përpara se të shpërthejë me pasojë të tmerrshme.

Në maj Shtëpia e Bardhë kishte bllokuar dërgesën në Izrael, por me sa duket kishte mbetur ende diçka në arsenalet e furnizimeve të mëparshme amerikane. Është vetëm një pjesë e enigmës, e cila demonstron lëvizjen e ethshme të armëve për luftën në Lindjen e Mesme.

Gara e armatimeve e shkaktuar nga konfliktet që na rrethojnë, nga Izraeli në Ukrainë dhe çfarë mund të shpërthejë në Lindjen e Largët, është përshpejtuar në mënyrë të paprecedentë. Në vitin 2023, shpenzimet ushtarake globale arritën një kulm prej 2,433

miliardë dollarësh, sipas të dhënave nga Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve të Paqes në Stokholm (SIPRI). Rritja më e fortë në 14 vitet e fundit, ku për herë të parë që nga viti 2009, regjistron një rritje në të pesë makrorajonet e globit, nga Afrika në Azi.

“Të gjithë po armatosen jo për të bërë, por për të shmangur Luftën e Tretë Botërore”, vëren Gianandrea Gaiani, drejtor i Analizës së Mbrojtjes. “Problemi është se rritja e prodhimit të armatimeve kërkon investime të larta dhe personel të specializuar. Dhe nevojitet një planifikim shumëvjeçar. A jemi të sigurt se mund të gjenden burimet?”

Pjesa e luanit shkon gjithmonë për Shtetet e Bashkuara, me shpenzime prej 916 miliardë dollarësh, të ndjekura nga Kina dhe Rusia. Evropa, e alarmuar nga konflikti ukrainas.

“Çështja më e mprehtë ka të bëjë me kohën”, vëren sërish Gaiani. “Nëse porositni tanke sot, do t’i keni pas dhjetë vjetësh. A do të ketë ende nevojë për të luftuar rusët?” Muri i Donbasit rrezikon

të jetë më i lartë se ai i Berlinit, por një faktor tjetër është “nxitimi për riarmatim”.

“Përfiton industria amerikane, e cila ka aftësinë të prodhojë çdo gjë shpejt dhe më pas t’i shesë armët në Evropë. Nëse Kontinenti i Vjetër po grumbullon avionë luftarakë F-35 dhe F-16, ku është mbrojtja e BE-së?”

«Dokumenti programatik shumëvjeçar 2024-2026» parashikon pesë F-35 për Marinën, të cilat i shtohen 19-ve tashmë në blerje. Forcat Ajrore do të marrin 24 avionë luftarakë Eurofighter Typhoon (7.4 miliardë euro) duke filluar nga ky vit. Megjithatë, sfida për t’u fituar është programi për luftëtarin e gjeneratës së gjashtë (Global Combat Air Programme), që dikur quhej Tempest. 7.7 miliardë do të shpenzohen për kërkimin dhe zhvillimin. Marina do të marrë dy Fremm Evos, anije luftarake futuriste (1.5 miliardë) dhe anijen Olterra për operacione speciale nënujore. Pavarësisht përpjekjeve, BE ndodhet ende prapa objektivit prej 2 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto për Mbrojtjen, të arritur në vitin 2014 nga amerikanët, ndryshe nga 23 vendet aleate që duhet të respektojnë angazhimin këtë vit. “Nëse në NATO duhet të arrish 2 për qind të PBB-së dhe për Bashkimin Europian nuk mund të kalosh një deficit prej 3 për qind, është e qartë se të dy kriteret janë në kontrast”, vëren Stefano Pontecorvo, president i

Leonardo. “Një pjesë e zgjidhjes është zbritja e shpenzimeve të mbrojtjes nga pragu i BE-së. Dhe të paktën financimi i investimeve në kërkime në këtë fushë me eurobono”.

Polonia, e cila në vitin 2025 do të shpenzojë 43 miliardë euro për mbrojtjen, duke arritur në 4.7 për qind të PBB-së, po bëhet Prusia e Evropës. Jo vetëm kaq: presidenti, Andrzej Duda, zbuloi se janë duke u zhvilluar negociatat me Uashingtonin për të instaluar armë bërthamore amerikane në territorin polak. 12 gushtin e kaluar u firmos kontrata për prodhimin e 48 baterive për raketat Patriot në uzinën Stalowa Wola.

Nuk është rastësi që ambasadori amerikan në Varshavë është Mark Brzezinski, djali i Zbignievit, këshilltar për sigurinë kombëtare me origjinë polake, i cili me Presidentin Jimmy Carter ishte një nga arkitektët e rënies së BRSS. Më 13 gusht, u njoftua blerja e 96 helikopterëve sulmues Apache për 10 miliardë dollarë. Polonia ka porositur nga Koreja e Jugut 48 avionë luftarakë të lehtë, 280 raketa-hedhës K239 Chunmoo në terren, 600 avionë vetëlëvizës K9 Thunder 155 mm dhe një mijë tanke K2.


Në Gjermani, debati për vendosjen e raketave të reja amerikane Tomahawk nga viti 2026 është i ashpër. Kancelari gjerman, Olaf Scholz, kishte rënë dakord në mënyrë diskrete me Presidentin Joe Biden në korrik, por opozita e ekstremit të djathtë

(AfD) dhe të majtë (BSW), e cila po rritet, është kundër.

Tim Thies i Institutit për Kërkimin e Politikave të Paqes dhe Sigurisë në Hamburg nuk ka asnjë dyshim: “Ne po shkojmë drejt një gare të re dhe të rëndë armatimesh”.

Gjermania është tashmë ndër pesë eksportuesit kryesorë të mbrojtjes në botë pas Shteteve të Bashkuara, Francës, Ruisë dhe Kinës. Lufta në Evropë ka nxitur në mënyrë të pashmangshme riarmatimin: shpenzimet ushtarake u rritën në 39 nga 43 shtetet e kontinentit në vitin 2023. Kulmi u arrit nga Ukraina, kryesisht me paratë perëndimore (+51 përqind) dhe nga Rusia (+24). Më 27 shtator, qeveria e Kievit paraqiti një projekt-ligj për të ndarë 60 për qind të buxhetit të vitit 2025 për sektorët e mbrojtjes dhe sigurisë (48.3 miliardë euro, por do të jenë 12 miliardë neto nga ndihma aleate).

Rusia dëshiron të investojë 30 për qind më shumë në mbrojtje (130 miliardë euro) dhe sapo ka thirrur 133 mijë burra për rekrutimin e vjeshtës. Vladimir Putin shpalli doktrinën e re bërthamore më 27 shtator: “Agresioni kundër Ruisë nga çdo shtet jo-bërthamor, por me pjesëmarrjen ose mbështetjen e një shteti bërthamor, do të konsiderohet një sulm i përbashkët (...), i cili do të krijonte qartë kushtet për Rusinë për të kaluar në përdorimin e armëve bërthamore”. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Gjyqtarët e Kosovës delegohen për ta ndarë drejtësinë në Ligën e Konferencës

Gjyqtarët e Kosovës do të jenë të angazhuar gjatë kësaj jave në arenën evropiane, më saktësisht në Ligën e

Konferencës. Të martën u dha njoftimi se pesë gjyqtarët nga Kosova do të jenë përgjegjës për ndarjen e

drejtësisë në duelin që do të zhvillohet në mes të Djurgardenit dhe Vitoria SC. Genc Nuza gjyqtar kryesor i

këtij takimi do të ndihmohet nga dy asistentët e tij Edmond Zeqiri dhe Granit Hyseni. Në rolin e gjyqtarit të

katërt do të jetë Ilir Mehmeti teksa asistent në dhomën e VAR-it është caktuar Dardan Çaka.

## Sonte superndeshja Barcelonë - Bayern

### “Epoka e re”

BARCELONË, 22 TETOR - Një superndeshje do të zhvillohet në Ligën e Kampionëve, sonte (e mërkurë). Barcelona e pret Bayern Munchenin. Lidhur me këtë ndeshje ka folur Hansi Flick, trajneri i Barcelonës, i cili ka thënë se klubi gjerman luan mirë dhe ka lojtarë të jashtëzakonshëm. “Shumë gjëra mund të ndodhin në ndeshje dhe gjërat mund të evoluojnë në një mënyrë që ne nuk e presim. Ne vetëm duhet të mendojmë për ndeshjen. Çdo ndeshje është e rëndësishme në këtë periudhë dhe ne duhet të ecim hap pas hapi. Bëhet fjalë për një kundërshtar që luan shumë mirë,

me lojtarë të jashtëzakonshëm”, ka thënë Flick, i cili në të kaluarën e ka drejtuar me sukses Bayernin, derisa në këtë ndeshje synon të dalë fitimtar me klubin spanjoll: “Bayerni ishte i veçantë në jetën time. Është një klub i madh dhe kam shumë marrëdhënie të mira me lojtarë dhe trajnerë. Ishte një moment i bukur, por mbetet një kujtim. Dua të fitojmë”.

Barcelona në La Liga është duke shkëlqyer dhe renditet në vendin e parë, pasi ka regjistruar nëntë fitore dhe një humbje. Ndërsa në Ligën e Kampionëve, klubi spanjoll nga dy ndeshje ka regjistruar një fitore ndaj Young Boysit dhe një humbje nga Monaco. Për këtë ndeshje ka folur edhe trajneri i Bayernit, Vicent Kompany, që ka thënë se

### Të mërkurën takohen:

18:45 Atalanta - Celtic  
18:45 Brest - Bayer Leverkusen  
21:00 Atletico Madrid - Lille  
21:00 Barcelona - Bayern Munchen  
21:00 Benfica - Feyenoord  
21:00 Manchester City - Sparta Prague  
21:00 RB Leipzig - Liverpool  
21:00 RB Salzburg - Dinamo Zagreb  
21:00 Young Boys - Inter

radhën e ka Barcelona. “Ne kemi fituar dhe kemi festuar pak përpara se të përballlemi me Barcelonën. Jemi gjithmonë duke punuar në detaje për të vazhduar të përmirësohemi. Radhën tani e ka Barcelona. Do të bëjmë gjithçka për të fituar kundër ekipit të Hansi Flick”, ka thënë Kompany.



Bayern Munchen është në vendin e parë në Bundesliga. Në shtatë ndeshje regjistroi pesë fitore dhe dy barazime, derisa në

Ligën e Kampionëve e mposhti bindshëm Dinamo Zagrebin e me pas humbi nga Aston Villa. Kjo ndeshje fillon në orën 21:00.



## Trepça kërkon fitoren e parë

MITROVICË, 22 TETOR - KB Trepça sonte (e mërkurë) do ta ketë ndeshjen e tretë në grupet e FIBA Europe Cup, përkatësisht të dytën radhazi në shtëpi. Mitrovicasit do të ndeshen me Caledonia Gladiators nga Skocia. Të dyja skuadrat kanë

nga dy humbje në dy ndeshjet e para në Grupin H të FIBA Europe Cup. “Xehetarët” pësuan nga Dijon 118:73 dhe MHP RIESEN Ludwigsburg 57:70, kurse Caledonia Gladiators pësuan nga MHP RIESEN Ludwigsburg 86:62 dhe Dijon

54:90. Në përballjen tjetër të këtij grupi, Dijon dhe Ludwigsburg do të ndeshen për vendin e parë. Ky është edicioni i dytë radhazi për Trepçën që luan në grupet e FIBA Europe Cup. Sfida zhvillohet nga ora 18:30 dhe transmetohet në Art Motion.

## Federata e Ping Pongut e Kosovës gati t'i mirëpresë eventet e World Table Tennis

Federata e Ping Pongut e Kosovës është gati për fillimin e eventeve të WTT Youth Contender Prishtina 2024 dhe WTT Feeder Prishtina 2024. Ky lajm shënon një çast të veçantë për sportin në Kosovë, ngaqë për herë të parë organizohet një event i një përmase të tillë. “FPPK ka punuar vazhdimisht për ta zhvilluar dhe promovuar pingpongun si një

sport të njohur dhe të respektuar. FPPK është duke bashkëpunuar me World Table Tennis për të siguruar çdo detaj të nevojshëm, nga infrastruktura deri te menaxhimi i eventeve. Me këto aktivitete, FPPK po shpreson ta rrisë ndjeshëm nivelin e pingpongut në vend dhe të inkurajojë më shumë të rinj që të angazhohen në këtë sport”,

thuhet në njoftim. Eventet e World Table Tennis pritet të tërheqin një numër të madh vizitorësh dhe mediash, duke kontribuar kështu në promovimin e Kosovës si një destinacion sportiv. FPPK ka njoftuar se është e gatshme për këtë sfidë dhe mezi pret të mirëpresë sportistë dhe tifozë nga e gjithë bota.

## Asani e vazhdon shkëlqimin në Ligën e Kampionëve Aziatikë

Jasir Asani po vazhdon të shkëlqejë në futbollin aziatik. Repreruesi i Shqipërisë ka qenë protagonist në ndeshjen që ekipi i tij, Gwangju FC, i cili e mposhti skuadrën Johor Darul Ta'zim FC me rezultat 3-1. Ishte pikërisht Asani që ia solli fitoren ekipit jug-korean në ndeshjen e vlefshme për Ligën e Kampionëve të Azisë.

Futbollisti shqiptar nga Maqedonia e Veriut i shënoi dy gola të shpejtë në fillim të takimit, respektivisht në minutat 3 dhe 6 për ta bërë ekipin e tij lider në grup në Lindje me tri fitore nga po aq ndeshje. Ai arriti në kuotën e gjashtë golave në Championsin aziatik në tri ndeshje të zhvilluara, statistika këto impresionuese, ndërsa e ka edhe një asistim.

## Kurshumlja dhe Mumini delegohen për ndeshje të rëndësishme ndërkombëtare

Komisari i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Faton Kurshumlja, është deleguar për dy ndeshje ndërkombëtare që do të zhvillohen në Bullgari. Kurshumlja do të jetë delegat në

sfidën Rilski Sportist - Alba Fehervar në grupet e FIBA Europe Cup për meshkuj. Ky takim do të zhvillohet më 29 tetor, ndërsa një ditë më pas do të jetë delegat në ndeshjen BC Balkan-Club

Deportivo, po ashtu në grupet e FIBA Europe Cup. Gjyqtari i njohur, Xhelal Mumini, do të ndajë drejtësinë në kualifikimet e FIBA Women's Eurobasket ndërmjet Maqedonisë Veriore dhe Ukrainës,

takim që zhvillohet më 7 nëntor. Mumini, po ashtu, do të jetë gjyqtar në dy ndeshje të rëndësishme në grupet e FIBA EuroCup Women mes Geas Basket-Sport Lisbona më 24 tetor në Itali dhe takimin

Galatasaray-Club Universitario de Ferrol, më 30 tetor në Turqi. Kurshumlja dhe Mumini kanë qenë të deleguar edhe më parë në gara evropiane dhe kanë përvojë nga garat ndërkombëtare.

## Manaj dhe Uzunin në formacionin më të mirë

**TIRANË, 22 TETOR** - Rey Manaj dhe Myrto Uzuni ishin dy nga mungesat e mëdha të Shqipërisë në dy takimet e muajit tetor. Të dy sulmuesit kuqezi kishin shqetësime muskulore, por lajmi i mirë ishte rikthimi i tyre në

kushte optimale. Manaj dhe Uzuni jo vetëm që zbritën nga minuta e parë këtë fundjavë, por të dy ishin protagonistë absolutë duke realizuar “dopietë” golash për ekipet respektive. Tifozët e Sivassporit u çmendën pasi Rey

Manaj shfaqti një formë fantastike duke realizuar dy gola. Paraqitja e tij ka bërë që Manaj të sigurojë një vend mes formacionit më të mirë të javës ku së bashku me Mauro Icardi formon dyshen e sulmit në

javën e 9 të Superligës turke. Me “dopietë” u rikthye edhe Myrto Uzuni, me “bomberin” beratas që vijon ta udhëheqë ekipin e tij, Granada. Paraqitja e shkëlqyer e Uzunit ka bërë që sulmuesi të sigurojë një vend mes



formacionit më të mirë në La Liga 2.

## Kroos: Për pensionimin pjesa më e vështirë ishte t'i tregojta Ancelottit dhe djalit tim

**MADRID, 22 TETOR** - Toni Kroos në një intervistë për mediumin spanjoll “MARCA”, e para e tij pas pensionimit nga futbollit aktiv, ka folur për sezonin e tij të fundit me fanellën e bardhë dhe vështirësitë që kishte për ta komunikuar vendimin e tij për pensionim. Legjenda gjermane ka pranuar se pjesa më e vështirë ishte që ai këtë vendim t'ia bënte me dije djalit të tij dhe trajnerit Carlo Ancelotti. “Ishte me të vërtetë më e vështirë për t'i treguar djalit tim të madh sepse e dija sa shumë e ka shijuar të më shihte në televizor dhe në stadium. Ai ka përjetuar kaq shumë momente, ka qenë në katër finale të Ligës së Kampionëve dhe si fëmijë ai nuk do ta harrojë kurrë këtë”, ka thënë Kroos. “Dhe ishte shumë e vështirë që t'i tregojta Carlosit pasi ai priste që unë të vazhdoja dhe ne ende kemi një raport shumë të mirë. Ai ishte trajneri im i parë këtu, kështu që nuk ishte e lehtë t'i tregojta, por në jetë gjithçka ka një fund. Nuk ishte e lehtë. E dija se Ancelotti nuk do të



zemërohej, por do të ishte paksa i mërzhitur. Nuk ishte një moment i lehtë as për mua sepse e dija se është fundi i diçkaje të veçantë”, ka shtuar Kroos. “Unë u mundova ta gjej kohën e duhur, një moment të lehtë, dhe isha me fat që e fituam Ligën e Kampionëve dhe mendova ‘tani!’.

Do të ishte më e vështirë nëse do të luftonim për kampionatin, pasi nuk doja që kjo temë të linte në hije çdo gjë tjetër”, ka përfunduar Kroos. Ai, gjithashtu, zbuloi se drejtuesit e klubit u munduan ta bindin që të vazhdojë ende, por që vendimi që kishte marrë ishte përfundimtar dhe i pakthyeshem.

## Leclerc: Mund të fitojmë titullin për konstruktorë, ai për pilotë është ende ‘në sirtar’

**MARANDELLO, 22 TETOR** - Nga zhgënjimi në Singapor dy muaj më parë të triumfi i dyfishtë në Amerikë. Është e qartë që në Maranello kanë punuar fort për ta rikthyer Ferrarin protagonist në pistat e Formula dhe e deri-diku e prisnin këtë rikthimin triumfues. Përditësimet e sjella fillimisht në Monza e më pas në garat e tjera kanë dhënë efektin e duhur të “kokëkuqja”, që tani e sheh veten në garë për të dueluar për titullin kampion për konstruktorë. Ferrari ka vetëm 48 pikë për të rikuperuar ndaj McLaren në krye të renditjes së konstruktorëve, ndërsa Red Bulli është vetëm 8 pikë larg. Ndaj Charles Leclerc nënvijëzon se janë vetë pilotët ata që kanë në dorë fatin e botërorit. “Nëse bëjmë gjithçka mirë dhe vazhdojmë të përfundojmë përpara McLarenit



deri në fund të sezonit do të jemi në gjendje t'i parakalojmë në renditje dhe të fitojmë titullin për konstruktorë, duke llogaritur vetëm veten dhe paraqitjet tona”, ka thënë Leclerc. “Kishim kohë që prisnim

një triumf të tillë. Për sa i përket titullit për pilotë asnjëherë nuk themi kurrë, por për t'u shpallur kampion aty duhet edhe pak fat. Aty ëndrra është ende në sirtar”, u shpreh Charles Leclerc.

### SHKURT

#### Interi pritët të rivalizojë Juven për Ismajlin

Kredencialet po i shtohen çdo javë e më shumë. Ardian Ismajli padyshim që është një nga lojtarët në Serinë A, ndërsa për shërbimet e tij ka hyrë në garë edhe një klub tjetër i madh italian. Mediet në Apenine shkruajnë se, përveç Juventusit, tashmë edhe Interi mund të konkurojë për kartonin e mbrojtësit të kombëtares shqiptare. Do të jetë një tjetër derbi i Italisë përveç atij që do të luhet fundjavën e ardhshme në kampionat. Ismajli u paraqit mirë edhe ndaj Napolit, duke përballuar sfidën me sulmuesin kryesor mik Romelu Lukaku, ndonëse nuk e shmangu dot humbjen 0-1 në shtëpi me ish-kampionët, pas golit me penalti të Kvarackelias. Dueli i suksesshëm ndaj belgut erdhi pas atyre ndaj Dushan Vlahoviçit të Juventusit dhe Artjom Dovybik të Romës. Padyshim që 28-vjeçari ka qenë tepër i fortë edhe me kuqezinjtë duke shënuar edhe gol në fitoren 2-1 në Pragë ndaj Ukrainës në Ligën e Kombeve. Në një periudhë krize financiare për futbollin italian, Ismajli do të ishte një zgjedhje shumë e mirë nga ana ekonomike, ndërsa për Juven apo Interin mund të pranonte edhe ta niste ndeshjen nga stoli. Kartoni i tij kushton 5 milionë euro, pak për standardin e Serisë A, ndërsa për mbrojtësin është një kulm që ai e arriti pikërisht pak ditë më parë, më 18 tetor.

#### Numri 1 në botë penalizohet, ndryshime në krye të renditjes botërore për femra

Tenistja bjelloruse Aryna Sabalenka është rikthyer pas një viti në krye të renditjes botërore. Ajo ka përfutuar nga një penalizim prej 120 pikësh që ka marrë tenistja polake Iga Swiatek, që ka zbritur në vendin e dytë. Një penalizim që ka ardhur si pasojë e rregullores, ku një teniste duhet të marrë pjesë në 16 turne WTA: 10 janë turne Masters 1000 dhe gjashtë janë turne të kategorisë 500. Swiatek ka marrë pjesë në 13 turne, duke humbur 120 pikë. Edhe Sabalenka ka marrë pjesë në më pak turne se lejohet, por ka humbur vetëm 10 pikë, duke bërë që dy tenistet më të mira në botë të bëjnë rokadë në krye të renditjes. Sabalenka ka aktualisht 9.706 pikë, ndërsa Swiatek 9.665 pikë. Gjithsesi, rivaliteti mes dy tenistëve do të vijojë deri të turneun e fundit të këtij viti, në atë WTA Finals, që zhvillohet në Riad. Ndërsa tenistet e tjera janë shumë larg në renditje, me amerikanen Coco Gauff që renditet e treta me 5.963 pikë.

#### Neymari rikthehet në fushë pas një viti: Ndjesi e jashtëzakonshme

Më 17 tetor 2023 bota e Neymarit u përmbys, me sulmuesin që këputi ligamentet e gjurit gjatë ndeshjes Brazil-Urugui. Një vit më pas, më 21 tetor makthi i Neymarit përfundoi me brazilianin që u rikthye për herë të parë në fushë gjatë ndeshjes Al Hilal-Al Ain, e vlefshme për Champions League aziatike. Neymar u hodh në fushë në minutën e 77-të kur rezultati ishte 5-3 në favor të ekipit të tij, Al Hilal. Lojtarët e ekipit saudit bënë gjithçka që braziliani të festonte me gol në këtë rikthim, por braziliani nuk ia doli. Në përfundim të ndeshjes, Neymar nuk e fshehu gëzimin për këtë rikthim të tij në fushë pas një viti: “Ndihej shumë mirë, por ishte shumë e vështirë. Jam me të vërtetë i lumtur që jam rikthyer. Është ndeshje e jashtëzakonshme t'i ndjesh sërish fluturat në bark përpara një ndeshje”. Në fund Neymar festoi bashkë me pjesën tjetër të ekipit pasi Al Hilal doli me 3 pikë nga ky takim i mbyllur me shifrat 5-4.

## Mediet gjermane: Alonso largohet nga Leverkuseni, klubi ka gati dy alternativa

Xabi Alonso është kthyer në një kohë shumë të shkurtër në një nga trajnerët më të kërkuar në Evropë. Tekniku spanjoll udhëhoqi Bayer Leverkusenin drejt një titulli historik në Bundesligë, teksa edhe këtë vit

kërkon të përsëritë veten në nivelet më të larta. Interesimi rreth tij është rritur dhe Leverkuseni, që ia doli ta mbante gjatë verës duke i rinovuar kontratën, tashmë duket i sigurt se ai do t'i japë lamtumirën në

verën e vitit 2025. “Sky Sports DE” shpjegon se në klub janë të bindur se 42-vjeçari do t'ua japë lamtumirën gjermanëve për të shkuar në një nga klubet e mëdha që e vëzhgojnë me interes. Kjo kuptohet nga fakti se

ata kanë nisur kërkimin për pasardhësin e tij, duke piktuar dy emra. I pari është trajneri aktual i Shtutgartit, Sebastian Hënës, tjetri është zëvendëstrajneri i përfaqësueses së Gjermanisë, Sandro Vagner. Të

dy këta emra janë kontaktuar edhe nga klube të tjera të Bundesligës e jo vetëm, por Leverkuseni duket si opsioni më i mirë i mundshëm për ta duke pasur parasysh se çfarë skuadre i lë në dispozicion Xabi Alonso.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "TOBACCO" Sh.p.k. - Prizren në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë "TOBACCO" Sh.p.k. - Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.12.2024 në ora 10:00 në në Objektivin e Komunës së Prizrenit, zyra e administratës, do të organizohet debat publik nga Kompania "TOBACCO" Sh.p.k. - Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Fabrikën për Prodhimin e Ujit Mineral Natyral pa Gas në Prizren.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM


<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "TOBACCO" Sh.p.k. - Prizren, për Fabrikën për prodhimin e pijeve freskues, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vn.m.komente@rks-gov.net](mailto:vn.m.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nexhdet Maloku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Gentian Azemi nga Gjakova shpall të pavlefshme testin e maturës të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Arijanit Kuçi nga Deçani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 3.4 të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Erion Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl, 10.11.12 të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Marjeta Laski nga Gjakova shpall të pavlefshme Licencën e Punës Infermiere të lëshuar nga Oda e Infermierëve Mamive dhe Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

